

VENDIM
Nr. 768, datë 16.9.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS "PASHO HYSA", TË BASHKISË SË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës "Pasho Hysa", sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë "truell", me sipërfaqe 1 764 (një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) m², me vlerë të përgjithshme 53 024 076 (pesëdhjetë e tre milionë e njëzet e katër mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 53 024 076 (pesëdhjetë e tre milionë e njëzet e katër mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatin e parashikuar nga Bashkia e Tiranës.
 8. Regjistrimi i ri i pasurisë "truell", prej 1 764 (një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) m², për ndërtimin e rrugës, të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia e Tiranës dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për rikonstruksionin e rrugës "Pasho Hysa"

Nr	EMER MBIEMER	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	Sipërf. Përgj./ m ²	SIP. Tr. të prekur / m ²	Çmimi për m ²	Vlefëta në lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë
1	Milto Ngjel Ngjela	8180	11/140	200	28	30.059	841.652	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
2	Gëzim Ali Demiri	8180	9/267	330	15	30.059	450.885	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
3	Mexhit Shaqir Cenaj	8180	9/129	518	11	30.059	330.649	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
4	Shyqyri Dina	8180	9/298	507	10	30.059	300.590	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
5	Bajram Çupi	8180	9/224	520	21	30.059	631.239	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
6	Adriatik Ivzi Nazarko	8180	9/276	300	30	30.059	901.770	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
7	Bashkpronarët Kaimi	8180	9/318	24.874	659	30.059	19.808.881	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
8	Dhimitër Qiro Lena	8180	9/211	203	25	30.059	751.475	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
9	Avni Bajram Muça	8180	9/128	592	8	30.059	240.472	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
10	Petrit Mumajesi	8180	9/126	780	27	30.059	811.593	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
11	Trashigimtarët Mumajesi	8180	11/80	5353	191	30.059	5.741.269	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
12	Nimete Çela	8180	9/315	215	22	30.059	661.298	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
13	Nimete Çela	8180	9/529	2182	582	30.059	17.494.338	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
	Shoq. REAL ESTATE							
14	BALLKAN DINAMIC shpk	8180	11/76	266	50	30.059	1.502.950	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
15	Baftjar Ceka	8180	9/110	310	59	30.059	1.773.481	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
16	Sotir Ballo	8180	9/210	202	26	30.059	781.534	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
					1764	Shuma	53.024.076	lekë